



Prishtinë, 27 gusht 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1271\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave Nr. 1832-0- ZK Ratkoc, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** në Komunën e Rahovecit, të datës 09.07.2020 me nr. prot. 288/20 të aplikuesit personit fizik Zyber Morina, me adresë: fshati "Ratkoc" Komuna Rahovecit, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 27 gusht 2020 nxori këtë:

## V E N D I M

### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Zyber Morina për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në ngastrën kadastrale Nr. 1832-0 ZK Ratkoc, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, në Komunën e Rahovecit.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Zyber Morina me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGJ- 9027305 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.



- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi personi fizik Zyber Morina do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

### Arsyetim

- ZRRE, me datë 09.07.2020 nga aplikuesi personi fizik Zyber Morina, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në gastrën kadastrale Nr. 1832-0 ZK Ratkoc, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, shifra e konsumatorit DGJ- 9027305 që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Rahovecit.
  - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4946 të datës 09.07.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Vendimin 12 Nr. 91 të datës 25.06.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit e Komunës së Rahovecit.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Zyber Morina dhe dëshmive të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastrave kadastrave Nr. 1832-0 ZK Ratkoc, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** që do të vendosen në objekt, në Komunën e Rahovecit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

